



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.77

29 maj

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.567, datë 7.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Duka T2” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Tuçep 2” 3387
Vendim i KM nr.568, datë 7.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “K.I.S.I” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Kacni”..... 3401
Vendim i KM nr.569, datë 7.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Mak Olimpik” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj” 3413

VENDIM
Nr.567, datë 7.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “DUKA T2”, SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “TUÇEP 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Duka T2”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Tuçep 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 992 Rep
NR.178 Kol

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “TUÇEP 2”

Në Tiranë, në datën 5 maj 2008 (dy mijë e tetë), u paraqitën para meje notere Fatime B. Meta, e regjistruar në dhomën e noterisë Tiranë me adresë: rruga e Durrësit, pall.118, sh.1, ap.1, palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet “Autoritet Kontraktues”, përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.271, datë 4.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Tuçep 2”, përfaqësuar me autorizimin nr.1597/2, datë 13.2.2007, nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi NF nr.489018

dhe

Shoqërisë “Duka 2”, me seli në Lezhë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.33299, datë 31.3.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; regjistruar në organin tatimor me NIPT K48130531M, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Hysen Duka, i biri i Muharremit, i datëlindjes 25.4.1956, banues në Lezhë, lagjja Gurra, nr.150, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z1925816, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hyjje

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

1. i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknike dhe ekonomike të rrjetit elektrik kombëtar;

2. konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. vlerëson formën “BOT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;

4. është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

5. mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

1. ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Tuçep 2”, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë;

2. është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Tuçep 2”, komuna Ostren rrethi Bulqizë, me qëllimin prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës;

3. shoqëria “Duka 2” sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;

4. zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.271, datë 4.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Tuçep 2” dhe bien dakord për sa më poshtë.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Përkufizime dhe interpretime**

Kudo që në këtë marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ato do të kenë kuptimet përkatëse si më poshtë si vijon:

1. Kontrata e koncesionit: kjo kontratë, aneksi/aneokset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.

2. Ligji “Për koncesionet”: ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

3. Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Koncesionari: shoqëria “DUKA 2” sh.p.k., me seli në qytetin e Lezhës.

5. Hidrocentral: hidrocentrali “Tuçep 2”, me vendndodhje në Bulqizë, me fuqi të instaluar 1400 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 7 500 000 kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë, por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, basenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluar në të.

6. Objekti: financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentralit “Tuçep 2” dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

7. Investimi: vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të HEC-it, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.

8. Punimet: tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit “Tuçep 2”.

9. Fillimi i punimeve: zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.

10. Vënia në punë e hidrocentralit: fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.

11. Kontratat: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

12. Leje dhe licenca: akte administrative që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.

13. Tarifa koncesionare: sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.

14. Llogaritja e afateve: kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin

e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

15. Subjekti i furnizimit me energji elektrike: personi i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.

16. Sigurimi i kontratës: vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari.

17. Dokumentet e financimit: nënkuptojnë çdo marrëveshje huaje, njoftime, obligacione, marrëveshje me shkrim, marrëveshje garancie, deklarata regjistrimi ose zbulimi, marrëveshje varësie, hipoteke, vepra besimi, marrëveshje kredie, marrëveshje blerjeje policash ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera të regjistruara nga kompania e projektit në lidhje me financimin e projektimit, prokurimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së kompleksit dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, duke përfshirë çdo modifikim, plotësim, zgjerim, rinovim dhe zëvendësim të ndonjë financimi të tillë.

18. Pala financuese: nënkupton çdo person ose persona që japin financim borxhi ose rifinancim sipas dokumenteve financiare të kompanisë së projektit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kompleksit dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, si dhe pasardhësve dhe përfutësve të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues të besuar për atë person ose persona, por jo duke përfshirë një aksionar ose filial të një aksionari në lidhje me mbetjen borxh që përfshin entin.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është:

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit “Për koncesionet”, i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë: ndërtim, operim dhe transferim i të drejtës së pronësisë dhe operimit në përfundim të kontratës së koncesionit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit “Tuçep 2” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit “Tuçep 2”

Hidrocentrali “Tuçep 2” do të ndërtohet në rrjedhën e lumit Tuçepit, në rrethin Bulqizë, me këto karakteristika:

- Kuotat e veprave;	
- Kuota e veprës së marrjes	662 m;
- Kuota e godinës së centralit	552 m;
- Prurja llogaritëse	1,6 m ³ /sek;
- Fuqia e instaluar	1400 kW;
- Prodhimi i energjisë elektrike	7 500 000 kWh.

Neni 4

Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit “Tuçep 2” për një periudhë 35-vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Koncesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

1. Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së Koncesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues.

Neni 6

Monitorimi dhe mbikëqyrja e përgjithshme

1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që në çdo kohë, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

2. Mbikëqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të kontratës, të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që duhet të marrë dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.

2. Të ndihmojë Koncesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.

3. Të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuara në aneksin nr.2 bashkëlidhur.

4. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.

5. Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti i furnizimit të energjisë elektrike për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

6. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e hidrocentralit "Tuçep 2".

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

1. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues për miratim projektin e zbatimit brenda 6 (gjashtë)

muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

3. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;

5. Të marrë masa me qëllim që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë kontratë.

6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it "Tuçep 2" me fuqi të vendosur jo më pak se 1400 MW.

7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit.

8. Të shesë të gjithë prodhimin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të paktën për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para të prodhimit.

9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.

10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit.

11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi.

13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 166 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, nga të cilat 47 618 (dyzet e shtatë mijë e gjashtë qind e tetëmbëdhjetë) lekë do të investohen në makineri e pajisje, sipas listës së paraqitur nga ofertuesi në procedurën konkurruese.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 166 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, por jo më e vogël se 157 700 000 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e shtatë qind mijë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5 % të investimit total të parashikuar.

Neni 10

Programi punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e miratimit të projektit të zbatimit.

2. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 14 (katërmëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur.

3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11

Testimi i veprës

Në përfundim të punimeve duhet të kryhet testimi i pajisjeve për të siguruar funksionalitetin e hidrocentralit.

Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit.

Neni 12

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit në mënyrë të njëanshme, pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:

1. kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

2. në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;

3. kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues;

4. kur Koncesionari nuk jep përgjigje të argumentuar për shkeljen, brenda afatit 30-ditor (tridhjetë) të parashikuar në nenin 24 të kësaj kontrate.

Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

2. Zgjidhja e kontratës nga secila palë

- Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur:

a) përmbytja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar me marrëveshje mes tyre.

3. Zgjidhja e kontratës me konsensus

- Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e Koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga secila palë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e HEC-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentralit te Autoriteti Kontraktues.

4. Të drejtat e palëve financuese

1. Njoftimi mbi shkeljen e kontratës

Menjëherë pas marrjes dijeni për një shkelje të kontratës nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues njofton për këtë palët financuese me qëllim të dhënies së mundësisë palëve financuese për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këtë Shkelje të kontratës nga Koncesionari brenda (90) nëntëdhjetë ditësh nga data e një njoftimi të tillë dhe Autoriteti Kontraktues u jep palëve financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se një shkelje kontrate nga Koncesionari nuk korrigjohet prej Koncesionarit brenda kohës së zbatueshme sipas seksionit 12.1.4 ose nuk korrigjohet ndryshe sipas seksionit 12.4.1 të mësipërm, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i bëjë Koncesionarit njoftimin e prishjes së kontratës.

Pavarësisht nga sa më sipër, njoftimi për prishjen e kontratës do të konsiderohet i tërhequr nëse, para hyrjes së saj në fuqi, Palët Financuese zgjedhin, në pajtim me ligjin:

i) të realizojnë një të drejtë pengu mbi aksionet; dhe/ose

ii) propozojnë t'ia transferojnë projektin një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues për qëllimin e vazhimit të projektit.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues:

i) nuk pengon apo vonon në mënyrë të paarsyeshme pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar menaxherial ose subjekti ka ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit; dhe

ii) bën ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me palët kontraktuese;

me kusht që, në pajtim me ligjin "Për koncesionet", ky zëvendësim të jetë i kufizuar në një periudhë prej (12) dymbëdhjetë muajsh të njëpasnjëshëm, dhe në çdo kohë gjatë kësaj periudhe Autoriteti Kontraktues organizon një proces të ri tenderimi për projektin, siç parashikohet më poshtë.

3. Procesi i tenderimit

Nëse Autoriteti Kontraktues organizon një proces tenderimi për projektin në pajtim me ligjin siç parashikohet në seksionin 12.4.2 më sipër, ai do të kërkojë mendimet dhe përfshin në mënyrë të arsyeshme palët financuese (me kërkesë të tyre) në përgatitjen dhe zbatimin e procesit të tenderimit (duke përfshirë

përgatitjen, negociimin dhe finalizimin e marrëveshjes së ndryshuar të koncesionit me një koncesionar palë të tretë) me qëllim sigurimin e vazhdimin të projektit duke marrë parasysh interesat e Autoritetit Kontraktues dhe palëve financuese.

4. Bërja e pagesave për prishjen e kontratës

Nëse, pavarësisht seksioneve 12.4.1 deri 12.4.3 më sipër, palët financuese zgjedhin për të mos ushtruar të drejtat e parashikuara atje, ose pavarësisht ushtrimit të këtyre të drejtave nuk shihet asnjë opsion i arsyeshëm vazhdimi dhe projekti duhet të ndërpritet, Autoriteti Kontraktues mund ta prishë këtë marrëveshje dhe, me kërkesën e parë të palëve financuese, bën pagesat e prishjes së kontratës në mënyrën e treguar atje.

Neni 13

Kontratat

Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit.

Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj kontrate koncesioni.

Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14

Sigurimi i kontratës

Koncesionari, para firmosjes së kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 50 352 936 (pesëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e dymijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, që përbën 10 % të vlerës totale të investimit.

Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Koncesionarit i lejohej të çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë kryer investimin e plotë dhe të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit, kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë e saj.

Neni 15

Sigurimet

Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë fazës së shfrytëzimit, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruksi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.

Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t’u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ngjarje dhe 500 000 (pesëqind mijë) euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 (një mijë) euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dy mijë) euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

1. Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 2 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së Koncesionit.

2. Vlera e riinvestimit

Çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet Koncesionari do të riinvestojë 40 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17
Kufizimet

Koncesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë.

Për çdo transferim të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet në pronësi të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër pa miratim të Autoritetit Kontraktues mbi asetet që do të ndërtohen apo blihen prej tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 18
Raportimi

Koncesionari është i detyruar që çdo tre muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19
Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 20
Forca madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore, katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve.

Në rastet e forcës madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose pezullimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në rast se kontrata do të zgjidhet për shkak të forcës madhore asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi ndaj palës tjetër për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbushja e kontratës.

Neni 21
Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të jetë gjykata e arbitrazhit që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të neneve 400 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore/të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj kontrate.

Neni 23

Sanksionet

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 14-mujore (katërmëdhjetë) të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- a) për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
- b) për moskryerje në total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuara.
- c) për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- a) në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 7 500 000 kWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese;
- b) për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Koncesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 2 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% të vlerës së investimit.

Sanksionet paguhet në llogari të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30-ditore (tridhjetë) lidhur me shkeljen.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Neni 24

Rregullimi i shkeljeve

Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit Koncesionari ka shkelur ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30-ditore (tridhjetë) përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse.

Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25

Transferimi i asetëve

Me mbarimin e kontratës së koncesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e koncesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e koncesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

Transferimi do të përfshijë, por pa u kufizuar në to:

- dorëzimin fizik të aseteve.
 - dorëzimin e dokumenteve që shoqërojnë këto asete;
 - kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asete;
 - kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Koncesionari.
- Koncesionari duhet të garantojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

Neni 26

Mbarimi i kontratës

Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35-vjeçar (tridhjetë e pesë vjeçar).

Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27

Konfidencialiteti

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28

Ndryshime

Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të dyja palëve.

Çdo amendim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të cilësdo prej këtyre koordinatave.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj kontrate.

Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Bul. Zogu i Parë, nr.1001,
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria “Duka T2” sh.p.k.
Lagjja Gura, nr.150
Lezhë, Tiranë – Shqipëri
Tel. +355 21523125
Cel. +355 682370718
e-mail: hydro-t2@yahoo.com

Neni 30

Regjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Përfaqësuar me autorizimin nr.1597/2
datë 13.2.2007 të Ministrit të Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës
Nga z.Kristo Rodi

KONCESIONARI

Shoqëria "Duka T2" sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Administratori
z.Hysen Duka

HIDROCENTRALI TUÇEP 2 BULQIZË
PREVENTIV

Aneksi 1

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefte
	I. VEPRA E MARRJES				
1	Gërmime	m ³	150	800	120000
2	Betone	m ³	130	15000	1950000
3	Hekur betoni	tonë	1,7	96000	163200
4	Konstruksion metalik	tonë	0,2	112000	22400
	Shuma I	lekë			2255600
	II. DEKANTUESI				
1	Gërmime	m ³	250	650	162500
2	Betone	m ³	90	12000	1080000
3	Hekur betoni	tonë	7,5	95000	712500
4	Konstruksione metalike	tonë	1	112000	112000
	Shuma II	lekë			2067000
	III. KANALI I SJELLJES				
1	Gërmime	m ³	10500	1000	10500000
2	Betone për puseta	m ³	110	12000	1320000
3	Hekur betoni	tonë	10	95000	950000
4	Tub met d=900 mm l=130 m	tonë	20	140000	2800000
5	Tub polietileni d=1200 mm	ml	970	15800	15326000
6	Mbushje me dhe	m ³	2800	190	1600000
	Shuma III				32496000
	IV. BASENI ME PRESION				
1	Gërmime	m ³	350	950	332500
2	Betone	m ³	200	12000	2400000
3	Hekur betoni	tonë	12	95000	1140000
4	Konstruksione metalike	tonë	0,5	112000	56000
	Shuma IV	lekë			3928500
	V. TUBACIONI I TURBINAVE				
1	Gërmime	m ³	1200	1100	1320000
2	Betone për ankera	m ³	200	12000	2400000
3	Hekur betoni	tonë	0,8	95000	76000
4	Tb met. D=900 mm, t=7 mm	tonë	60	170000	10200000
5	Mbushje me dhe	m ³	1000	250	250000
	Shuma V	lekë			14246000
	VI. SHKARKUESI NGA BASENI				
1	Gërmime	m ³	100	1100	110000
2	Betone	m ³	10	12000	120000
3	Hekur betoni	tonë	0,3	95000	28500
4	Tubacion met.D=400 mm	tonë	4	140000	560000
	Shuma VI				818500
	VII. NDËRTESA E CENTRALIT				
1	Gërmime	m ³	1200	850	1020000

2	Betone bazamenti e rama	m ³	90	12500	1125000
3	Hekur betoni	tonë	15	95000	1425000
4	Vëllim ndërtese	m ³	1200	5500	6600000
	Shuma VII	lekë			10170000
	Shuma I +II+III+IV+V+VI+VII			lekë	65981600
	Rezervë 10%			lekë	6598160
	Shuma			lekë	72579760
	TVSH 20%			lekë	14520240
	Shuma			lekë	87100000
	Me kursin 123 lekë = 1 euro kemi rreth	euro			708000

Shpenzimet përmbledhëse

Punime ndërtimi (civile) 708 000 euro
 Pajisje teknologjike 542 000 euro
 Shpronësime 30 000 euro
 Studime e projektme 70 000 euro
Shuma 1 350 000 euro

ANEXS 2

G R A F I K U I P U N I M E V E

Nr	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	K O H A (M U A J)														
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	DOKUMENTACIONI		XXXXXX														
2	PROJEKTE		XXXXXX			XXXXXX	8000										
3	VEPRA E MARRJES					XXXXXX	3000										
4	KANALI I SIELLES					XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	43000			XXXXXX					
5	DEKANTUESI					XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX					
6	BASENTI ME PRESION								XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX					
7	TUBACIONI I TURBINAVE								XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX		
8	NDERTESA E CENTRALIT												XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX		
9	LEVRIMI I PAISIEVE TEKNOLOGJIKE												XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX		
10	MONTIME														XXXXXX	XXXXXX	
11	PROVA E DHE VENIA ME NGARKESE															XXXXXX	XXXXXX
12	REALIZIMI I FONDEVE (Nderim-montim) (shuma = 99400 mije)	mije lete				XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX	XXXXXX

OBJEKT: H.C. TUÇEP-2

POROSITES : HYSEN DUKA

FAZA : PROJEKT-IDE

EMERTIMI : GRAFIKU I PUNIMEVE

PROJEKTUES : EST A M TUDIDA

OBJEKT-IDE : 15000 T2

EMERTIMI : 15000 T2

PROJEKTUES : EST A M TUDIDA

[Signature]

[Signature]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS
Guaranty Certificate Performance Bond

Ref/ Ref. Number	008.00.1.22	Data/ Date	17.01.2008
------------------	-------------	------------	------------

Për/ To	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES TIRANE (Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority)		
Në emër të In the name of	"DUKA T2" SH.P.K LEZHE (Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar / Name and the address of the insured bidder)		
Procedura e prokurimit (Procurement procedure)	ME KONCENCION (Referenca e dosjes, percaktuar sipas autoritet kontraktor/ File reference according contracting authority)		
Pershkrim i shkurtër i kontrates (Short description of the contract)	Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralitet HEC-it të Tucep 2, fshati Tucep, Komuna Ostren, Bulqize (Lloji i procedurës dhe objekti / Kind of procedure and the object)		
Publikimi (nese zbatohet) Publication (if applicable)	Buletini i njoftimeve i njoftimeve publike Dt. _____ Nr. _____		
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur dhe me kusht që /referring to the former procedure, and with the condition that to:			
"DUKA T2" SH.P.K LEZHE (emri i ofertuesit të percaktuar fitues/ name of the bid winner)			
T'i jete akorduar kontrata, ne vertetojme se Has been accorded the contract, we certify that	"DUKA T2" SH.P.K LEZHE (emri i ofertuesit të percaktuar fitues/ name of the bid winner)		
Eshte garantuar prane shoqerise se sigurimeve interalbanian sh.a me nje vlerë prej: Has a guaranty at our company that has a value:	16.600.000 (Gjashtëmbëdhjetmilion e gjashtëqindmijë) LEKE (monedha dhe vlera e shprehur në fjalë dhe në shifra/ value and currency)		
Si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontrates që do të nënshkruhet me/as a condition for the execution of the contract signed with:	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES (emri i autoritetit kontraktor/ name of the contracting authority)		
Merrim përsipër të transferojmë në llogarinë We are liable to transfer at the account of	MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES (emri i autoritetit kontraktor / name of the contracting authority)		
Vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e pare me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të kontrates / the insured value within 15 (fifteen) days from your first written request, without giving any explanation, with the condition it contains that the contracts has not been fulfilled:			
Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontrates/ this insurance is valid up to the contract execution:			
Nga data/ from	17.01.2008	Deri më / Up to	përfundim të kontrates

17.01.2008
 interalbanian sh.a
 DEGA TIRANE

Nr.568, datë 7.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “K.I.S.I” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “KACNI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “K.I.S.I” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Kacni”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR.993 Rep
NR.179 Kol

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT
“KACNI”

Në Tiranë, në datën 5 maj 2008 (dy mijë e tetë), u paraqitën para meje notere Fatime B. Meta, e regjistruar në dhomën e noterisë Tiranë, me adresë: rruga e Durrësit, pall.118, sh.1, ap.1, palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcaktuar si “Autoritet kontraktues” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.270, datë 4.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kacni”, që më poshtë do të quhet i tillë, Z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftim NF nr.489018

dhe

Shoqëria “KISI” Sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr.19006, datë 11.3.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Rrahim Lala, i biri Myrtezanit, i datëlindjes 10.6.1964, banues në Peshkopi, lagja “Gjok Ndoci”, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z 0606568, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hyrje

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

1. i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknike dhe ekonomike të rrjetit elektrik kombëtar;

2. konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. vlerëson formën “BOT” të Koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;

4. është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

5. mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

5.1 legjislacioni në fuqi rregullon dhënien me koncesion të hidrocentraleve dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.270, datë 4.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Kacni”, autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

Koncesionari:

1. është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Kacni”, në komunën Selishtë, rrethi Dibër, me qëllimin prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;

2. shoqëria “KISI” sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshjeje;

3. ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Kacni”, objekt i këtij koncesioni;

4. zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ato do të kenë kuptimet përkatëse si më poshtë si vijon :

1.1 Marrëveshja e koncesionit: kjo marrëveshje dhe anekset 1 dhe 2 bashkëlidhur.

1.2 Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

1.3 Koncesionari: shoqëria “KISI” sh.p.k., me seli në Peshkopi.

1.4 Hidrocentral: tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike ku përfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, baseni i presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbina, ndërtesa e centralit, së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të, që në rastin konkret është Hidrocentrali “Kacni”, komuna Selishtë, rrethi Dibër, me fuqi të instaluar 1100 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 7 189 380 kWh, së bashku me të gjitha objektet që përmenden më sipër.

1.5 Kontratat: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

1.6 Licencë: është akti administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

1.7 Dokumentet e financimit: nënkuptojnë çdo marrëveshje huaje, njoftime, obligacione, marrëveshje me shkrim, marrëveshje garancie, deklarata regjistrimi ose zbulimi, marrëveshje varësie, hipoteke, vepra besimi, marrëveshje kredie, marrëveshje blerjeje policash ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera të regjistruara nga Kompania e Projektit në lidhje me financimin e projektimit, prokurimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Koncesionit, duke përfshirë çdo modifikim, plotësim, zgjerim, rinovim dhe zëvendësim të ndonjë financimi të tillë.

1.8 Pala financuese: nënkupton çdo person ose persona që japin financim borxhi ose rifinancim sipas dokumenteve financiare të kompanisë së projektit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Koncesionit, si dhe pasardhësve dhe përfituesve të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues të besuar për atë person ose persona, por jo duke përfshirë një Aksionar ose filial të një Aksionari në lidhje me mbetjen borxh që përfshin Entin.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është:

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit “Për koncesionet”, i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë: ndërtim, operim dhe transferim i të drejtës së pronësisë dhe operimit në përfundim të kontratës së koncesionit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate).

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit “Kacni” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Periudha e koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit “Kacni”, për një periudhë 35-vjeçare (tridhjetë e pesë) sipas shkronjës “b” të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.06.2006 “Për koncesionet”. Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues

4.1 Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

Të asistojë pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, për marrjen e licencave dhe të lejeve të nevojshme për koncesion.

4.2 Të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari. Koha e nevojshme për miratimin e projektit të zbatimit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuar në aneksin 2, bashkëlidhur.

4.3 Të kontrollojë rregullisht ecurinë e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

5.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit Koncesionari të formojë shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të aksioneve apo pjesëve të kapitalit të saj tek të tretët, duhet të marrë pëlqimin e Autoritetit Kontraktues.

5.2 Të fillojë punën brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e miratimit të projektit të zbatimit.

5.3 Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit nr.1 dhe nr.2 bashkëlidhur kontratës.

5.4 Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë koncesionare.

5.5 Të marrë masa me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë kontratë dhe me cilësinë e kërkuar.

5.6 Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit.

5.7 Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.

5.8 Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit.

5.9 Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjisllacionin shqiptar në fuqi; të marra masa për të garantuar kushtet teknike për punëtorët dhe të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private, të respektojë legjisllacionin në fuqi për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

5.10 Koncesionari detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe ato noteriale.

5.11 Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut të punimeve, aneksi 1, bashkëlidhur.

5.12 Të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it “Kacni” me fuqi të vendosur prej 1100 kW.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të Projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 133 121 000 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e njëqind e njëzetë e një mijë) lekësh, nga të cilat 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë do të investohen në makineri e pajisje, sipas listës së paraqitur nga ofertuesi në procedurën konkurruese.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;
- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 133 121 000 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e njëqind e njëzetë e një mijë) lekë, por jo më e vogël se 126 464 950 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total të parashikuar.

Neni 7

Programi i punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm të punimeve:

7.1 Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 24 (njëzetekatër) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit nr.2 bashkëlidhur kësaj kontrate.

7.2 Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, në se marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

8.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë e prishjen së kontratës së koncesionit në mënyrë të njëanshme:

a) kur Koncesionari nuk fillon punën brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

b) në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10% të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;

c) kur Koncesionari kryen transferimin, ose shitjen e kuotave pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

8.2 Kur nga ana e Autoritetit Kontraktues provohet se gjatë periudhës së koncesionit, ka shkelje të ndonjë prej pikave të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Në rast mbarimi të këtij afati dhe Koncesionari nuk sjell përgjigje, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

8.3 Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër, për kohësisht administrimin e HEC-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga Koncesionari, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.

8.4 Secila palë, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

8.5 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

8.6 Të drejtat e palëve financuese

1. Njoftimi mbi shkeljen e kontratës

Menjëherë pas marrjes dijeni për një shkelje të kontratës nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues njofton për këtë palët financuese me qëllim të dhënies së mundësisë palëve financuese për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këtë shkelje të kontratës nga Koncesionari brenda (90) nëntëdhjetë ditësh nga data e një njoftimi të tillë dhe Autoriteti Kontraktues u jep palëve Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se një shkelje kontrate nga Koncesionari nuk korrigjohet prej Koncesionarit brenda kohës së zbatueshme sipas seksionit 8.1.a ose nuk korrigjohet ndryshe sipas Seksionit 8.2 të mësipërm, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i bëjë Koncesionarit njoftimin e prishjes së kontratës.

Pavarësisht nga sa më sipër, njoftimi për prishjen e kontratës do të konsiderohet i tërhequr nëse, para hyrjes së saj në fuqi, palët financuese zgjedhin, në pajtim me ligjin:

- i) të realizojnë një të drejtë pengu mbi aksionet; dhe/ose
- ii) propozojnë t'ia transferojnë projektin një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues për qëllimin e vazhimit të projektit.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues:

i) nuk pengon apo vonon në mënyrë të paarsyeshme pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar menaxherial ose subjekti ka ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit; dhe

ii) bën ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me palët kontraktuese;

me kusht që, në pajtim me ligjin "Për koncesionet", ky zëvendësim të jetë i kufizuar në një periudhë prej (12) dymbëdhjetë muajsh të njëpasnjëshëm, dhe në çdo kohë gjatë kësaj periudhe Autoriteti Kontraktues organizon një proces të ri tenderimi për projektin, siç parashikohet më poshtë.

3. Procesi i tenderimit

Nëse Autoriteti Kontraktues organizon një proces tenderimi për projektin në pajtim me ligjin siç parashikohet në seksionin 8.6.2 më sipër, ai do të kërkojë mendimet dhe përfshin në mënyrë të arsyeshme palët financuese (me kërkesë të tyre) në përgatitjen dhe zbatimin e procesit të tenderimit (duke përfshirë përgatitjen, negociimin dhe finalizimin e marrëveshjes së ndryshuar të koncesionit me një koncesionar palë të tretë) me qëllim sigurimin e vazhimit të projektit duke marrë parasysh interesat e Autoritetit Kontraktues dhe palëve financuese.

4. Bërja e pagesave për prishjen e kontratës

Nëse, pavarësisht seksioneve 8.6.1 deri 8.6.3 më sipër, palët financuese zgjedhin për të mos ushtruar të drejtat e parashikuara atje, ose pavarësisht ushtrimit të këtyre të drejtave nuk shihet asnjë opsion i arsyeshëm vazhdimi dhe projekti duhet të ndërpritet, Autoriteti Kontraktues mund ta prishë këtë marrëveshje dhe, me kërkesën e parë të palëve financuese, bën pagesat e prishjes së kontratës në mënyrën e treguar atje.

Neni 9

Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes, ose nënkontraktorët, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj kontrate.

Pavarësisht nga kontratat e mësipërme, përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen Autoritetit Kontraktues në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

Koncesionari nuk ka të drejtë ta japë kontratën e koncesionit me nënkoncesion

Neni 10

Garancitë

Koncesionari duhet të garantojë, për llogari të autoritetit kontraktues, (sipas formularit të paraqitur në dokumentet e tenderit) para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 10% të vlerës totale të investimit prej 13 312 100 (trembëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind) lekësh.

Koncesionari i lejohej të çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga realizimi i investimit dhe kryerja e testimit të veprës.

Neni 11

Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale të para dëmtimit apo më mirë.

Kontraktori duhet të sigurohet për përgjegjësinë për dëme materiale dhe dëmtime trupore që mund t'u shkaktohen palëve të treta si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit/montimit si dhe gjatë funksionimit të tij.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ngjarje dhe 500 000 (pesëqind mijë) euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 (një mijë) euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dy mijë) euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 12

Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së Koncesionit.

Koncesionari është i detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike.

Autoriteti Kontraktues, ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar në se rregullat e koncesionit po kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Autoriteti Kontraktues, mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të kontratës, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 13

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

a) Tarifa koncesionare

Tarifa koncesionare është 2% e energjisë së prodhuar. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shesë këtë sasi energjie për llogari të tij.

b) Vlera e riinvestimit

Vlera e riinvestimit është 40 % e vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të investohet çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet dhe do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 14

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptari.

Neni 15

Forca madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj kontrate, duke bërë të pamundur përbushjen e detyrimeve reciproke të marrëveshjes, që kanë të

bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të Palëve, për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, ato nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj kontrate do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 16

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet midis palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, nuk do të anulojnë detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 18

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 24 mujore penalizon Koncesionarin si më poshtë:

18.1 Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës të investimeve të munguara.

18.2 Për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës të investimeve të parealizuar.

18.3 Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

18.4 Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 7 189 380 kWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të parealizuar për periudhën raportuese.

18.5 Për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, ai do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

18.6 Nëse mosrealizimi i fuqisë së vendosur është më shumë se 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të prishë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 19

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të cilësdo prej këtyre koordinatave.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj kontrate.

Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje janë:

Për Autoritetin Kontraktues
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Blvd. Zogu i Parë, nr.1001,
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin
Shoqëria “KISI” sh.p.k.
Komuna Muhurr
Rrethi Dibër, Shqipëri
Tel. +355 21822606
Cel. +355 68 40 47 577
Cel. +355 68 23 37 497

Neni 20

Transferimi i aseteve

Me mbarimin e marrëveshjes koncesionare, qoftë si përfundim i afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Koncesioneve, përfshirë çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e Koncesionit, do t'i transferohet Autoritetit Kontraktues, pa shpërblim, apo detyrim shtesë, subjekt i termave dhe kushteve të marrëveshjes koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, por jo detyrimin, të ndërhyjë në çdo kontratë të Koncesionarit.

Neni 21

Regjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar me Autorizimin nr.4432/5,
datë 31.10.2007 të
Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës,

Nga z.Kristo Rodi
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore

KONCESIONARI

Shoqëria “KISI” sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Rrahim Lala

PREVENTIVI PARAPRAK

Objekti : HEC-I KACNI PROJ PESHKUT KOMUNA SELISHTE

Faza: PROJEKTE - IDE

Nr	Emertimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte (lek)
A	VEPRA E MARRJES				
1	Germim dheu presence uji per devijim	M3	25	1000	25000
2	Mbushje me dhe te ngjeshur per priten	M3	7	800	5600
3	Germim dheu per bazamentin e vepres	M3	32	1000	32000
4	Beton M 150 per trupin e vepres	M3	26	10000	260000
5	FV hekur betoni	ton	2.6	120000	312000
6	FV porta metalike	ton	0.3	250000	75000
7	Mbushje me zhavorr per filtrim ne ane e sipërme	M3	3	1000	3000
8	Mbushje me gur ne anen e poshtme	M3	12	2000	24000
9	Mbushje me dhe te ngjeshur	M3	27	800	21600
	SHUMA 1				758200
B	DEKANTUESI				
1	Germim dheu	M3	22	800	17600
2	Mbushje me dhe te ngjeshur	M3	8	800	6400
3	Beton M 200 per vasken e dekantuesit	M3	12	12000	144000
4	FV hekur betoni	ton	1.2	120000	144000
5	FV porta metalike	ton	0.4	250000	100000
	SHUMA 2				412000
C	KANALIT DE VIRACIONIT				
1	Germim dheu me punetor	M3	600	500	300000
2	Beton M100 per shtrese	M2	60	8000	480000
3	Beton M200 per seksionin e kanalit	M3	140	12000	1680000
4	FV hekur betoni	ton	1.4	120000	168000
5	Shtrese zhavorri	M3	40	1000	40000
6	Llamarine xingato d=1.2mm	M2	290	1500	435000
7	Mbushje me dhe ngjeshje me tokmak	M3	90	1800	162000
8	Ndertim vepre artimbi e nenkalime	cop	2	300000	600000
9	Mbrojtje te kanalit nga gerryerjet,shembje	ml	24	20000	480000
	SHUMA 3				4345000
D	BASENI I PRESIONIT				
1	Germim dheu	M3	240	800	192000
2	Mbushje me dhe te ngjeshur	M3	45	800	36000
3	Shtrese zhavorri	M3	18	1000	18000
4	Llamarine xingato d=1.2mm	M2	28	1500	42000
5	Beton M200 per muret e vepres +bazamentin	M3	98	10000	980000
6	FV hekur betoni	ton	4.8	120000	576000
7	FV porta metalike	ton	0.4	250000	100000
8	Tub metalik d=400mm	ton	5	200000	1000000
9	Tub metalik d=250 mm	ton	2.5	200000	500000
	SHUMA 4				3444000
E	TUBACIONI I TURBINAVE				
1	Germim dheu	M3	610	800	488000
2	Beton M150 per ankerat	M3	112	10000	1120000
3	FV tubacion celiku d=400mm spres 8-10mm	ton	92	200000	18400000
4	FV kompesator me rula mbeshketes	cope	12	12500	150000
5	Lyerje tubacioni me dy duar anti-xho	M2	1130	300	339000

6	FV hekur betoni	ton	2.8	120000	336000
	SHUMA 5				22183000
G	NDERTESA E CENTRALIT				
1	Germim dheu ne presence uji	M3	260	1000	260000
2	Mbushje me dhe te ngjeshur	M3	115	800	92000
3	Beton M200 per bazamentin e ndertesës	M3	45	12000	540000
4	Beton M300 per bazament,kollona,frase e soleta	M3	120	12000	1440000
5	Beton M150 per shtresa	M3	60	10000	600000
6	Ndertim catie me tjegulla	M2	120	6000	720000
7	Beton per kanalet e shkarkimit M200	M3	15	12000	180000
8	FV hekur betoni	ton	16	120000	1920000
9	Muratur tulle	M3	88	5000	440000
10	Suvatime me llac cemento	M2	240	1500	360000
11	Lyerje me boje	M2	240	150	36000
12	FV dyer dhe dritare	M2	32	10000	320000
13	FV vinc ure	cop	1	500000	500000
14	Instalime elektrike te TU	cop	1	500000	500000
	SHUMA 6				7908000
H	RRUGA AUTOMOBILISTIKE				
1	Germim mbushje rivevim rruge b=4m	M3	4800	1000	480000
2	Shtrese gur kalldram + ngjeshje	M3	480	850	408000
3	Mbushje me cakull me dy shtresa 2 15 cm per rrug	M3	120	180	5424000
	SHUMA 7				5424000
I	PAISJE TEKNOLOGJIKE,HIDROELEKTRIKE DHE LINJA E TN				
1	Makineri e paisje ndihmese	kw	1100	50000	55000000
2	Punime montimi	lek			6000000
3	Asistence teknike	lek			3000000
4	Ndertim I nenstacionit 35/10 kv	lek	1	5000000	5000000
5	Lidhja me sistemin	km	2	1000000	2000000
	SHUMA 8				71000000
II	SHPRONESIME				
1	Toke are	M2	0	800	0
2	Kullota	M2	1500	400	600000
3	Truall	M2	0	6000	0
4	Zallishte	M2	0	50	0
	SHUMA 9				600000
III	PROJEKTI	leke			1200000
	SHUMA 10				1200000
	SHUMA 1+2+3+4+5+6+7+8+9+10				117227420
	Ngjitje kantjeri 2 %				781000
	Fondi reserve 5 %				2048127
	Futimi 5 %				2082727
	TVSH 20 %				9022777
	SHUMA TOTALE				134160000

Shënim. Programi punimeve spostohet në varësi të marrjes së të gjitha lejeve.

GRAFIKU I REALIZIMEVE TE PUNIMEVE PER NDERTIMIN E H/CENTRALIT KACNISE - PESHKOPI

Nr	Emertimi i Punimeve	VITI I PARE				VITI I DYTE			
		Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV	Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
I	PUNIME CIVILE								
1	NDERTIMI I VEPRES MARJES								
2	NDERTIMI DEKANTUESIT								
3	NDERTIMI KANALIT DEVIACIONIT								
4	NDERTIMI I BASENIT PRESIONIT								
5	MONTIMI I TUBACIONEVE TE TURBINES								
6	NDERTIMI I NDERTESSES SE H/C								
7	MONTIMI I SHKARKUESIT NE BASEN								
8	NDERTIMI I NENKALIMEVE TE RREKEVE								
9	NDERTIM RRUGE PROVIZORE								
14	NDERTIMI I SHKARKIMEVE TE UJRAVE								
II	PUNIME ELEKTRIKE								
1	LIDHJA ME LINJEN 10 kv TE SISTEMIT								
III	MONTIM MAKINERI DHE PAISJE								
1	MONTIMI I MAKINERIVE DHE PAISJEVE								
2	NDERTIMI I N/STACIONIT 10 Kv NE H/C								
3	MONTIMI I PAISJEVE NDIHMESE								
4	PROVA PA NGARKESE DHE ME NGARKESE								

KY GRAFIK FILLON TE ZBATOHET NGA MOMENTI I MARJES SE LEJES SE NDERTIMIT NGA MINISTRJA



"ATLANTIK" Sh. A. - SHOQERI SIGURIMESH

Drejtoria Qendrore: Rruga "Themistokli Gërmenji", nr.3/1 Tirane, Tel.: (04) 230 506, Fax: (04) 235 071.
Regjistruar me Vendim Gjykatë nr. 25720, datë 02.05.2001. Leja e KMS datë 01.06.2001. NIPT nr. K11807008V.

Seria **N^o** **039169**

FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATËS

Ref. 148

Data 08.10.2007.

Për: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Tirane
(Emri dhe adrese e autoritetit kontraktor)

Ne emër të: Shoqeria "KISI" Sh.p.k. Zyra e Fondit te Zhvillimit Shqiptar,
(emri dhe adresa e ofertuesit te siguruar) Peshkopi.

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): 008.001.17
(Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor)

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Per marrjen me koncesion te HEC -itte "Kacni",
(Lloji i procedures dhe objekti) fshati Kacni Kom. Selisht, Diber.

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr. _____, datë _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që RAHIM LALA
(emri i ofertuesit te percaktuar fitues)

t'i jetë akorduar kontrata, ne vertetojme se RAHIM LALA ka derdhur një
(emri i ofertuesit te percaktuar fitues)

depozitë pranë Shoqerisë së Sigurimeve "ATLANTIK" sh.a. në një shumë prej:
Lekë 13.312.100 Trembëdhjetë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e
(shuma me fjale) njëqind leke

si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Tirane
(Emri autoritetit kontraktor)

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Min. Ekon. Trg. Energj. Tir vlerën e
(Emri autoritetit kontraktor)

siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa
kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

Lëshuar në Peshkopi, me 08.10. 2007

SHOQERIA E SIGURIMEVE "ATLANTIK" sh.a

Përfaqësuesi [Firma]
(Emri mbieperi, firma, dula)

VENDIM
Nr.569, datë 7.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “MAK OLIMPIK” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “STRAVAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Mak Olimpik” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR.991 Rep
NR.177 Kol

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT
“STRAVAJ”

Në Tiranë, në datën 5 maj 2008 (dy mijë e tetë), u paraqitën para meje notere Fatime B.Meta, e regjistruar në dhomën e noterisë Tiranë me adresë: rruga e Durrësit, palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet “Autoritet kontraktues”, përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.306, datë 25.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Stravaj”, përfaqësuar me autorizimin nr.4428/17, datë 12.3.2008, nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi NF nr.489018 dhe

Shoqëria “Mak Olimpik” sh.p.k., me seli në Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.23432, datë 21.3.2008, të Gjykatës së Rrethit Tiranë; regjistruar në organin tatimor me NIPT K418040120, datë 17.12.2004, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Alfons Uka, i biri i Dedës, i datëlindjes 1965, banues në Tiranë, Rruga “Irfan Tomini” nr.22/1, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z1352471, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hyrje

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

1. i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

2. konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. vlerëson formën “BOT” të Koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;

4. është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

5. mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

1. ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Stravaj”, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë;

2. është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj”, komuna Stravaj, rrethi Librazhd, me qëllimin prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;

3. shoqëria “Mak Olimpik” sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;

4. zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë Koncesioni bazuar në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.306, datë 25.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Stravaj” dhe bien dakord për sa më poshtë:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizime dhe interpretime

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si më poshtë si vijon:

1. Kontrata e koncesionit: Kjo kontratë, aneksi/aneokset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.

2. Ligji “Për koncesionet”: ligji nr.9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

3. Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Koncesionari: shoqëria “Mak Olimpik” sh.p.k., me seli në qytetin e Tiranës.

5. Hidrocentral: hidrocentrali “Stravaj”, me vendndodhje në komunën Stravaj, rrethi Librazhd, me fuqi të instaluar 3,626 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 16 317 000 kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, basenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të.

6. Objekti: financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentralit “Stravaj” dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

7. Investimi: vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të HEC-it, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.

8. Punimet: tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit “Stravaj”.

9. Fillimi i punimeve: zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.

10. Vënia në punë e hidrocentralit: fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.

11. Kontratat: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve;

12. Leje dhe licenca: akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.

13. Tarifa koncesionare: sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.

14. Llogaritja e afateve: kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me

kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

15. Subjekti i furnizimit me energji elektrike: personi i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.

16. Sigurimi i kontratës: vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari.

17. Dokumentet e financimit: nënkuptojnë çdo marrëveshje huaje, njoftime, obligacione, marrëveshje me shkrim, marrëveshje garancie, deklarata regjistrimi ose zbulimi, marrëveshje varësie, hipoteke, vepra besimi, marrëveshje kredie, marrëveshje blerjeje policash ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera të regjistruara nga kompania e projektit në lidhje me financimin e projektimit, prokurimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Kompleksit dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, duke përfshirë çdo modifikim, plotësim, zgjerim, rinovim dhe zëvendësim të ndonjë financimi të tillë.

18. Pala financuese: nënkupton çdo person ose persona që japin financim borxhi ose rifinancim sipas dokumenteve financiare të kompanisë së projektit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kompleksit dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, si dhe pasardhësve dhe përfituesve të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues të besuar për atë person ose persona, por jo duke përfshirë një aksionar ose filial të një aksionari në lidhje me mbetjen borxh që përfshin entin.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është:

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit “Për koncesionet”, i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë: ndërtim, operim dhe transferim i të drejtës së pronësisë dhe operimit në përfundim të kontratës së koncesionit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate).

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit “Stravaj” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit “Stravaj”

Hidrocentrali “Stravaj” do të ndërtohet në rrjedhën e lumit Radiçine, duke shfrytëzuar 3 degët e tij, Frangovisht, Radigoze dhe Gjigjirome, në rrethin Librazhd, me këto karakteristika:

- Kuotat e veprave	
- Kuota e veprës së marrjes 1	840 m
- Kuota e veprës së marrjes 2	846 m
- Kuota e veprës së marrjes 3	848 m
- Kuota e godinës së centralit	708 m
- Prurja llogaritëse	3.4 m ³ /sek
- Fuqia e instaluar	3626 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike	16 317 000 kWh/vit

Neni 4

Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj” për një periudhë 35-vjeçare (tridhjetepesë).

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e

kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Koncesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

1. Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së Koncesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues.

Neni 6

Monitorimi dhe mbikëqyrja e përgjithshme

I. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në çdo kohë, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

1. Mbikëqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të kontratës, të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që duhet të marrë dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.

2. Të ndihmojë Koncesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.

3. Të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuara në aneksin nr. 1 bashkëlidhur.

4. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.

5. Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti i furnizimit të energjisë elektrike, për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

6. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e hidrocentralit "Stravaj".

KREU III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

1. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

3. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit 2 bashkëlidhur kontratës.

5. Të marrë masa me qëllim që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë.

6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it "Stravaj" me fuqi të vendosur jo më pak se 3626 Kw.

7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit.

8. Të shesë të gjithë prodhimin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të paktën për 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e para të prodhimit.

9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.

10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit.

11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi.

13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 503 529 364 (pesëqind e tre milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh, nga të cilat 156 250 000 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë do të investohen në makineri e pajisje, sipas listës së paraqitur nga ofertuesi në procedurën konkurruese.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 503 529 364 (pesëqind e tre milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, por jo më e vogël se 478 352 895 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5 % të investimit total të parashikuar.

Neni 10

Programi punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditësh nga data e miratimit të projektit të zbatimit.

2. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 14 (katërmëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur.

3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt

procedurale për marrjen e tyre.

4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonësive të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11

Testimi i veprës

Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i pajisjeve, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentralit.

Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit.

Neni 12

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidh kontratën e koncesionit në mënyrë të njëanshme, pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:

1. kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

2. në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;

3. kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues;

4. kur Koncesionari nuk jep përgjigje të argumentuar për shkeljen, brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 24 të kësaj kontrate.

Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

2. Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

- Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar me marrëveshje mes tyre.

3. Zgjidhja e kontratës me konsensus

- Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e Koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga secila palë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e HEC-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentralit te Autoriteti Kontraktues.

4. Të drejtat e palëve financuese

1. Njoftimi mbi Shkeljen e Kontratës

Menjëherë pas marrjes dijeni për një Shkelje të Kontratës nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues njofton për këtë Palët Financuese me qëllim të dhënies së mundësisë Palëve Financuese për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këtë Shkelje të Kontratës nga Koncesionari brenda (90) nëntëdhjetë ditësh nga data e një njoftimi të tillë dhe Autoriteti Kontraktues u jep Palëve Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se një shkelje kontrate nga Koncesionari nuk korrigjohet prej Koncesionarit brenda kohës së zbatueshme sipas seksionit 12.1.4 ose nuk korrigjohet ndryshe sipas seksionit 12.4.1 të mësipërm, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i bëjë Koncesionarit njoftimin e prishjes së kontratës.

Pavarësisht nga sa më sipër, Njoftimi për Prishjen e Kontratës do të konsiderohet i tërhequr nëse, para hyrjes së saj në fuqi, palët financuese zgjedhin, në pajtim me ligjin:

i) të realizojnë një të drejtë pengu mbi aksionet; dhe/ose

ii) propozojnë t'ia transferojnë projektin një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues për qëllimin e vazhdimin të projektit.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues:

i) nuk pengon apo vonon në mënyrë të paarsyeshme pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar menaxherial ose subjekti ka ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit; dhe

ii) bën ato veprime që kërkojnë ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me palët kontraktuese;

me kusht që, në pajtim me ligjin “Për koncesionet”, ky zëvendësim të jetë i kufizuar në një periudhë prej (12) dymbëdhjetë muajsh të njëpasnjëshëm, dhe në çdo kohë gjatë kësaj periudhe Autoriteti Kontraktues organizon një proces të ri tenderimi për Projektin, siç parashikohet më poshtë.

3. Procesi i tenderimit

Nëse Autoriteti Kontraktues organizon një proces tenderimi për projektin në pajtim me ligjin siç parashikohet në seksionin 12.4.2 më sipër, ai do të kërkojë mendimet dhe përfshin në mënyrë të arsyeshme palët financuese (me kërkesë të tyre) në përgatitjen dhe zbatimin e procesit të tenderimit (duke përfshirë përgatitjen, negociimin dhe finalizimin e marrëveshjes së ndryshuar të koncesionit me një koncesionar palë të tretë) me qëllim sigurimin e vazhdimin të projektit duke marrë parasysh interesat e Autoritetit Kontraktues dhe palëve financuese.

4. Bërja e pagesave për prishjen e kontratës

Nëse, pavarësisht seksioneve 12.4.1 deri 12.4.3 më sipër, palët financuese zgjedhin për të mos ushtruar të drejtat e parashikuara atje, ose pavarësisht ushtrimit të këtyre të drejtave nuk shihet asnjë opsion i arsyeshëm vazhdimi dhe Projekti duhet të ndërpritet, Autoriteti Kontraktues mund ta prishë këtë marrëveshje dhe, me kërkesën e parë të palëve financuese, bën pagesat e prishjes së kontratës në mënyrën e treguar atje.

Neni 13

Kontratat

Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit.

Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj kontrate koncesioni.

Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14

Sigurimi i kontratës

Koncesionari, para firmosjes së kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 50 352 936 (pesëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e dymijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, që përbën 10 % të vlerës totale të investimit.

Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Koncesionarit i lejohet të çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë kryer investimin e plotë dhe të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga realizimi i investimit, kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë e saj.

Neni 15

Sigurimet

Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë fazës së shfrytëzimit, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” gjatë gjithë periudhës së koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit e

kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.

Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ngjarje dhe 500 000 (pesëqind mijë) euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 (një mijë) euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dy mijë) euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

1. Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 5 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së Koncesionit.

2. Vlera e riinvestimit

Çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet Koncesionari do të riinvestojë 50 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17

Kufizimet

Koncesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë.

Për çdo transferim të kapitalit themeltar të saj te të tretët Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet në pronësi të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër pa miratim të Autoritetit Kontraktues mbi asetet që do të ndërtohen apo blihen prej tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 18

Raportimi

Koncesionari është i detyruar që çdo tre muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 20

Forca Madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore, katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve.

Në rastet e forcës madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose pezullimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbytjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në rast se kontrata do të zgjidhet për shkak të forcës madhore asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi ndaj palës tjetër për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbytja e kontratës.

Neni 21

Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kontrata e koncesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të jetë gjykata e arbitrazhit që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të neneve 400 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore/të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj kontrate.

Neni 23

Sanksionet

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 14 (katërmëdhjetë) mujore të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- a) për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara;
- b) për moskryerje në total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuara;
- c) për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- a) në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 16 317 000 kWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese;
- b) për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Koncesionari do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 2 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% të vlerës së investimit.

Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore lidhur me shkeljen.

Pas përfundimit të kësaj periudhe, kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 10 (dhjetë) ditësh.

Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Neni 24
Rregullimi i shkeljeve

Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30 (tridhjetë) ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse.

Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25
Transferimi i aseteve

Me mbarimin e kontratës së koncesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Koncesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e Koncesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:

- dorëzimin fizik të aseteve;
- dorëzimin e dokumenteve që shoqërojnë këto asete;
- kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asete;
- kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Koncesionari.

Koncesionari duhet të garantojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

Neni 26
Mbarimi i kontratës

Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35-vjeçar (tridhjetë e pesë).

Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27
Konfidencialiteti

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28
Ndryshime

Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të dy palëve.

Çdo amendim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29
Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të behet me shkrim, ne adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të cilësdo prej këtyre koordinatave.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj kontrate.

Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës
Blvd. Zogu i Parë, nr.1001,
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria “Mak Olimpik” sh.p.k.
Rruga:”Abdi Toptani”, Torre Drin
Kati i dytë, Tiranë - Shqipëri
Tel. +355 4 271242
Fax.+355 4 274857

Neni 30

Regjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës
Përfaqësuar me Autorizimin nr.4428/17 prot.
datë 12.3.2008 të Ministrit të Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës
Nga z.Kristo Rodi

KONCESIONARI

Shoqëria “Mak Olimpik” sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Administratori
z.Alfons Uka

Preventivi paraprak

Objekti : HEC-i STRAVAJ

Faza: Projekt Ide

Nr	Emertimi i punimit	Vlefte (Leke)
1	VEPRA E MARRJES 1	
	Nenshuma 1	2,890,000
2	KANALI SJELLJES 1	
	Nenshuma 2	56,259,500
3	VEPRA E MARRJES 2	
	Nenshuma 3	2,765,500
4	KANALI SJELLJES 2	
	Nenshuma 4	25,830,000
5	VEPRA E MARRJES 3	
	Nenshuma 5	3,400,000
6	KANALI SJELLJES 3	
	Nenshuma 6	46,903,000
7	SIFONI 1	
	Nenshuma 7	3,888,000
8	SIFONI 2	
	Nenshuma 8	18,186,000
9	DEKANTUESI 1	
	Nenshuma 9	3,137,500
10	DEKANTUESI 2	
	Nenshuma 10	2,545,500
11	DEKANTUESI 3	
	Nenshuma 11	2,683,000
12	BASENI ME PRESION	
	Nenshuma 12	13,295,000
13	TUBACIONI I TURBINAVE	
	Nenshuma 13	32,665,000
14	NDERTESA E CENTRALIT	
	Nenshuma 14	22,950,000
15	PUNIME KANTJERI, PER RRUGE, etj.	
	Nenshuma 15	7,121,940
16	REZERVE 6%	
	Nenshuma 16	14,671,196
	Total nenshumat 1+2+3+4+5+6+7+8+9+10+11+12+13+14+15+16	259,191,136
	TVSH 20%	51,838,227
SHUMA PUNIME CIVILE		311,029,363
17	MAKINERI E PAJISJE	
	Nenshuma 17	128,750,000
18	LIDHJA ME SISTEMIN	
	Nenshuma 18	27,500,000
19	SHPRONESIME	
	Nenshuma 19	12,500,000
20	STUDIM PROJEKTIM	
	Nenshuma 20	23,750,000
TOTALI		503,529,363



Nr. Serie/ Serial No 0007421
Dega/ Branch
Kodi/ Code:


FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS
Guaranty Certificate Performance Bond

Ref / Ref Numer	008.00.1.16	Data/ Date	22.02.2008
Për/ To	MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJISTIKES (Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority)		
Në emër të In the name of	SHOQERIA MAK OLIMPIC SHPK (Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar / Name and the address of the insured bidder)		
Procedura e prokurimit (Procurement procedure)	008.00.1.16 (referenca e dosjes, percaktuar sipas autoritet kontraktor/ file reference according contracting authority)		
Pershkrim i shkurtër i kontrates (Short description of the contract)	DHENIEN ME KONCENSION DHE NDERTIMI I HEC-IT "STRAVAJ", KOMUNA STRAVAJ, RRETHI LIBRAZHD (Iloji i procedurës dhe objekti / kind of procedure and the object)		
Publikimi (nese zbatohet) Publication (if applicable)	Buletini i njoftimeve i njoftimeve publike Dt. _____ Nr. _____ Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur dhe me kusht që /referring to the former procedure, and with the condition that to: MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJISTIKES (emri i ofertuesit të përcaktuar fitues/ name of the bid winner)		
T'i jete akorduar kontrata, ne vertetojme se Has been accorded the contract, we certify that	SHOQERIA MAK OLIMPIC SHPK (emri i ofertuesit të përcaktuar fitues/ name of the bid winner)		
Eshte garantuar prane bashkimit te shoqerive te sigurimeve me nje vlere prej: Has a guaranty at our company that has a value:	LEK 50.352.936 (Pesedhjetemilion e treqind e pesedhjetë e dy mijë e nentëqinde tridhjetë e gjashtë) (monedha dhe vlera e shprehur në fjalë dhe në shifra/ value and currency)		
Si kusht per sigurimin e ekzekutimit te kontrates qe do te nenshkruhet me /as a condition for the execution of the contract signed with:	MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJISTIKES (emri i autoritetit kontraktor/ name of the contracting authority)		
Marrim persiper te transferojme ne llogarine e We are liable to transfer at the account of	MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJISTIKES (emri i autoritetit kontraktor / name of the contracting authority)		
Vleren e siguruar , menjehere nga kerkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkese te permende mospermblidhjen e kushteve te kontrates / the insured value immediately from your first written request, without giving any explanation, with the condition it contains that the contracts has not been fulfilled:			
Ky sigurim eshte i vlefshwm deri nw zbatimin e plote te kontratws/ this insurance is valid up to the contract execution:			
Nga data/ from	22.02.2008	Deri më / Up to	14 (katërmbëdhjetë) muaj

Shoqeria Inter-albanian Sha



Shoqeria Intersig Sha



Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 28.5.2008
Doli nga shtypi më 29.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë